

NDËRRIMET E FILOZOFISË DHE SISTEMIT EDUKATIV NE REPUBLIKËN SLLOVENE

Prof.dr. Pavle Zgaga

CEPS — Qendra për studime të strategjive edukuese në Univerzitetin e Lubjanës, Slloveni

Proceset që kanë karakterizuar veprimtarinë edukative në dhjetëvjetshin e fundit në Republikën e Sllovenisë, mund të rreshtojmë me të drejtë në kapitullin “dhjetë vjet ndryshime”. Proceset në të cilat janë hulumtuar dhe përgatitur konceptet e reja teorike e pastaj janë aplikuar në praktikë në kohën e tashme janë bërë çështje interesimi i shteteve tjera në regjion dhe me gjërë në skenën ndërkombëtare. Ekspertët publik në regjion (në veçanti në shtetet që kanë dalur nga ish Jugosllavia) me lehtësi do të kuptojnë kuptimin e këtyre proceseve, sepse shumë nga problemet kanë qënë të njëjtë apo të ngjajshëm në periudhën e viteve të nëntdhjetta. Kushtet e ndryshme historike kanë ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve në ato shtete, por eksperiencat e përfituar mund të aplikohen shumë mirë. Në dhjetëvjetshin e kaluar kemi shfrytëzuar në mënyrë kritike eksperiencat e shteteve të tjera jashtë regjionit të ngushtë dhe në atë mënyrë kemi lehtësuar kreimin dhe kualitetin e vendosjeve tona eksperte, prandaj jemi të mendimit se kjo lloj dëshmie do të zgjojë interesim për lexuesit në ato shtete. Në këtë paraqitje dëshiroj të prezantoj gjithëmbartësin e problemeve në edukim me të cilat jemi ballafaquar (apo ende ballafaqohemi), filozofinë e afrimit të analizës së tyre, metodat e zgjedhjes si dhe rezultatet e arritura. Jam i bindur se lexuesit në shtetet e Europës juglindore do të mund të akceptojnë ato elemente të cilat mund të u ndihmojnë në progresin e sistemit vendorë të edukimit në kushte të sotme.

1. Zgjedhja e problemeve aktuale të grumbulluara (1990- 1993)

Fillimi i viteve të nëntdhjetta për shumicën e shteteve në Europën juglindore paraqet kthesë të madhe historike. Këtu behet fjalë për procese të njohura dhe thellësisht të analizuar. Këtu nuk është e nevojshme të ndalemi në shpalosjen e këtyre proceseve. Nëse problemet e sistemit edukativ i shikojmë në kontekstin e proceseve politike dhe sociale në fillim të etapës kur filloj mvehtesimi i republikave të ish Jugosllavisë thjeshtë mund të konstatojmë se nuk bëhet fjalë për tema të rangut dytësorë por ishin tema që janë kyçe në zhvillimin e kombeve moderne. Në fundin e viteve të tetëdhjetta ishim të sfiduar me dy strategji: me sfidën e kalimit në shoqërinë moderne plurale (“tranzicioni”) gjë që ishte karakteristike vetëm për shtetet e Europës Qëndrore dhe asaj Lindore, si dhe me sfidën e information modern gjegjësisht knowledge based society, i cili nga vitet e tetëdhjetta e këtej u bë sfidë në krejtë botën. Jam i bindur se, proceset në sferën e edukimit në vendet tona ishin të vlersuara gabimisht nëse i qasemi nga sfida e parë prej të dyjave. Gjithësesi, këto procese tek në ishin shumë kompleks sepse me rastësi historike i kanë mbuluar faktorët “regjional” dhe “global”, por duhet të kemi gjithëmonë në mendje se ndryshimet në sistemin e edukimit nuk ishin të nevojshme (vetëm) për shkak të ndryshimeve politike. Të detyrueshme janë vetëm për shkak të ndryshimeve globale dhe civilizuese.

Për këto fjalë të mëdha ishim koshjent në fund të viteve të tetëdhjetta: do të perkujtojsa në debatet e ashpra për shoqërinë “postmoderne” apo mbi “shoqërinë civile”. Në çast kur nën ndikimin e kushteve historike erdhi deri aty që të merret timoni të shkohet në vozitje të re, për çka ishte ëndërruar vite me rradhë, tabloja u bë shumë më pragmatike. Autori i këtij teksti në u bashkangjiti në pranverën e vitit 1992, ekipit të ri të Ministrisë së Shkollës dhe Sportit (dhe mbeti në të plotë tetë vite deri në vitin 2000), ajo ekip erdhi me ndjenjë të mirë nga fakultetet

e institutet e ndryshme të universitetit. Problemi qëndror nuk ishte mangësia e ideve të reja por përkundrazi zgjedhja e problemeve të grumbulluara.

Ndryshimet në sistemin politik kerkojshin ndryshime të shpejta dhe në sistemin edukativ. Këtu bëhet fjalë për ndryshime të cilat nuk ishin të lidhura me futjen e strategjive të reja të mësimi, metodave alternative në trendet më të reja shkencore e në veçanti në degë të posaçme, por njëkohësisht kërkoheshin zgjedhje administrative funksionale dhe pragmatike si psh.: si të bëhet kalimi dhe të realizohet ai nga mënyra e financimit të “Bvizmit” në atë të mënyres klasike duke mos kolabruar sistemi i edukimit por të avancojmë atë? Si të shtjem në jetë ndryshimet në vëndosjen e drejtorëve e që ndërkohë të sigurohet përgjegjësia e shkollës ndja rrethit, të shtohet motivacioni i mësuesve dhe prindërve e njëkohësisht të ndërpreht “partitokracia”. Pra, fjala është për ndryshimet formale të ligjëvënësve në veçanti në lëminë e organizimit dhe financimit të arësimi, për gjëndjen të mësuesve dhe marrëveshjeve kolektive, mbi rregullimin e shkollave private dhe futjes së tyre në sistemin edukativ në veçanti sa i përket kualitetit, mundësisë së kalimit të nxënësve nga një shkollë në tjetrën etj. Përpos problemeve të mbrëndëshme nuk ishte e mundur të harrohet (të lihet pas dore) marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale në pranimin e dëftesave, si dhe në futje të projektve ndërkombëtare arësimore. Poashtu u ballafaquem me problemet e zgjedhjes së fëmijve të refugjatëve nga zonat e atëhershme të luftës. Në fakt, në vend të ndërrimeve të filozofisë së gjithëmbarrëshme në sistem të edukimit u “mbytem” në baltin e jetës reale. Dhe ashtu e mësuem lektionin e parë, pra atë më të rëndësishmin: jeta është gjithëmonë e para.

Problemet e “tranzicionit “ dhe zgjedhja e tyre (1991-1995)

Vetë koshjenca se jeta është gjëja më e rëndësishme nuk don të thotë se duhet çua dorë nga analiza e ndryshimeve dhe përgatitja e programeve. Përkundrazi, problemet reale të grumbulluara janë pika kaluese e ndryshimeve të shkallëzuara dhe përmirsimi i sistemit. Problemet thelbësore nga të cilët filloi të lindë strategjia e ndryshimeve mundë të rëndësim në shumë tema. Këtu do të përqendrohemi në ato më të rëndësishmet.

Përputhshëria e ndryshimeve sociale politike dhe lokale dhe ndryshimeve civilizuese për të cilët kemi cek më parë kushtëzuan në nivelin konkret ndryshimet kruciale në kërkesat e tregut të punës por dhe në intereset dhe ambicjet e individëve. Qëndrimi ndaj edukimit dhe dijes së përfituar filloi të ndryshohet: dija bëhet shumë pak (vetëm) shkak formal i hyrjes në jetë aktive dhe shumë më shumë realisht ndikon në pozitën individuale dhe në pasqyrimin individual në “shoqëri të hapur”. Në strukturën e edukimit ekzistues posaçërisht shkollimit të lartë dhe të mesëm, në ato kushte u paraqit një pyetje e vështirë: si të kënaqet kërkesa për vende të lira në shkolla dhe fakultete. Kjo pyetje është e vështirë jo vetëm sa i përket mjeteve financiare u ngarkue dhe me procese specifike “tranzite”. Thyerja e “gjiganteve ekonomike” të dikurshme dhe rritja e papunësisë çuan në sistemin edukativ në ndryshime momentale të intereseve të rregjistrimit të gjeneratave të reja: popullaritetin e dikurshëm të teknikut mekanik e ndërroi për krye nate popullariteti i tregtarëve dhe ekonomistëve. Përpos ndryshimin në edukimin profesional me të madhe u rrit numri i atyreve të cilët pas shkollës fillore rregjistrohet në atë të mesme dhe pastaj në shkollë të lartë dhe fakultete. E gjithë kjo shkaktoj shtypje të mëdha në rrjetin shkollor të cilën duhej të adaptoj me shpejtësi, të zgjëroj apo të përmirsojë.

Problemet aktuale të grumbulluara që në shikim të parë nuk duken se kan lidhëshmëri me çështjet filozofike të strategjisë së sistemit edukativ, në atë shkallë fillojnë të kërkojnë

pikërisht atë: analizen e thukhtë, simulimin e skenarjeve zhvilluese, kërkimin e metodave edukuese me të cilat është e mundur të kundërshtohen proceset negative. Problemi themelorë i sistemit edukativ të shteteve në tranzicion mundë të formulohet shumë thjesht: kapëshmëria e kualitetit shkollor për të gjithë që shprehin dëshirë dhe kanë aftësi për atë gjë. Lënja pas dore e atij koncepti nënkupton vetëm zvarritjen e problemeve në të ardhmën, kjo nënkupton njëkohësisht rrezikun që problemi të rritet deri në skajshmëri. Këtu s'bahet fjalë për të rinjtë që mbesin në rrugë dhe në mënyrë afatgjatë ngarkojnë strategjinë nacionale dhe programet sociale por njëkohësisht dhe shkatërrimin e rrjetit shkollorë dhe demotivimit të mësuesve etj. Ky tablo i errët mundë të anashkalohet vetëm nëse na shpjen në zgjedhjet pragmatike të problemeve themelore, kjo gjë është fitimprurëse vetëm nëse kujdeset për funksionimin afatgjatë të sistemit dhe kualitetit të edukimit.

Me ndërrimin e intereseve për rregjistrim dhe lidhur me të rrjetit shkollorë, kjo dukuri kërkon qasje racionale në kushtet e edukimit., Këtu bëhet fjalë për librat shkollorë, bashkohësisë dhe kualitetit alternativës gjegjësisht mundësisë zgjedhore. Poashtu takohemi me shumë çështje sociale, bursat, konviktet, ushqimi, udhëtimi etj., por gjithashtu dhe çështjet e përrimit të mësuesisë dhe të gjithë atyreve eksperteve që janë të punësuar në edukim. Përfundimisht këto janë sfida të cilat kurrësi nuk duhet përqafuar siç është luksi dhe veset e ndryshme: futja e teknologjive të reja në edukim, mësimi i gjuhëve të huaja, arësimimi i tërëjetshëm mobiliteti ndërkombëtarë etj. Pra, tek në çdo ditë takohemi me fjalën, se nuk jemi aq të pasur që të blejm gjëra të lira. Kur flasim për sistemet nacionale në edukim kjo fjali na mëson shumë. Nëqoftëse funksionet themelore edukuese nuk janë të kujdesura në mënyrë të rregulltë na shpjen në rrugë të kolapsit sistemorë. Jetësimi i tij është shumë i shtrënjët për buxhetin shtetërorë, në disa elemente papërmirueshem (psh. Gjenerata e cila e ka lëshuar shancin) kurse në disa elemente shumë e mirëpritur (shkaqet sociale dhe kuturore).

Nuk do të ishte aspak e pazakonshme poqëse do mëndojshtin kështu të gjithë ekspertet që punojnë në arsim. Përkundrazi kjo gjë është normale por nuk është e mjaftueshme. Arsimin duhet kuptuar si prioritet nacional dhe ti jepet pesha e duhur por nga ajo të kërohen poashtu rezultate të duhura. Në Slloveni, sa i përket kësaj, shumë i rëndësishëm ishte “Ligji për sigurimin e mjeteve për disa programe zhvillimore në edukim dhe arsim në Republikën e Sllovenisë” të cilën e aprovoj Parlamenti i shtetit në vitin 1994 i cili i garantojë ketij projekti 27.548.000.000. SIT, mjete shtesë për periudhën 1994-1999. Kështu Sllovenija në mesin e viteve të nëntëdhjetta bëri kërcim për 4,8% të BDP që iu dedikua edukimit, pra arrijti nivelin që e preferonte në mes organizatave të ndryshme dhe UNESCO .

Çështja kyçe e argumenteve që lejojnë përfundim të cekur mundëson dhe lehtëson vendimi politik mbi prioritetet pra, mbi kualitetin organizativ të sistemit dhe zhvillimin e sektorëve që premtojnë dhe garantojnë përparim. Në pjesën e parë të viteve nëntëdhjetta vend të posaçëm u dedikua për organizimin e ministrisë së arsimit dhe zhvillimit të sektorve të sajë. Në sajë të situatës të cilën e gjetëm duhej së pari të ndërtojm ministrin. Bashkësit tona edukuese dhe disa forma të përparshme organizative nuk do të mundësim ti aprovojmë pa rezervë si pjesë të administratës shtetërore i cili mundë të ballafaqohet lehtësisht me sfidat e situatës së dhënë historike.

Koncepti i shoqërisë së hapur demokratike nuk përfundon me formimin dhe e aparatit shtetërorë. Edukimi është çështje vetanake në lëmin ndaj të cilit shoqëria civile dhe ingerencat shtetërore duhet të ishin të kujdesëshme për shkak të vijuesve në arsim për të drejta të prindërve, bashkësive lokale autonomisë së shkencës profesionit.... Në disa tradita që i akceptojmë si të përbashkëta në vitet nëntëdhjetta kan lindë trupa ekspertesh. Kështu ne, trashëguem Këshillin ekspert për arsim dhe edukim të Republikës së Sllovenisë, i cili pësoj

ndryshueshmëri në formë dhe funksion. Në pjesën e parë të viteve të nëntëdhjetta kur u vertetsua bindja për çështjen e rëndësishme të arsimimit profesional ishte formua Këshilli ekspert për edukimin e të rriturve mbi rolin e edukimit gjithëjetësorë si dhe Këshilli ekspert për të rritur në Republikën e Sllovenisë. Këto tre këshille eksperte fituen vertetim me ligjet e reja nga viti 1996 ., e postaj dhe me vendimin e Qeverisë ose të Ministrisë filluen punën dhe disa tjrë (posaçërisht i rëndësishëm ishte Këshilli kurikularë, aty ishte dhe këshilli për edukimin e edukimit të fëmijve me kërkesa të veçanta për edukimin muzikorë për gjuhë të huaja etj.) . Ne këtu merremi me edukim terciar, poashtu shtojmë se në mënyrë të njëjtë në vitin 1994 filloi me punë Këshilli për shkollim të lartë në R.S. (shkollimi i lartë gjatë krejtë periudhës ishte nën ingerencat e Ministrisë së arsimit). Të gjitha këto trupe eksperte që disa prej tyre punojnë në shumë komisione afruen rreth vehtës numër të madh të eksperteve të lëmive të ndryshme të edukimit ose jashtë tij (punësimi, sindikati, shoqatat etj.) mundësuan iniciativa në rreth të gjërë dhe shëndërimi i eksperiencave dhe mëndimeve.

Në këshillat profesionale bashkohen ekspertet – si ata individual apo si përfaqësues të institucioneve të cilët kanë me Ligjë autorizime të vertetuara (si psh. Të pranimit i planprogrameve të përgatitja e rregulloreve të reja etj.) Rol shumë të rëndësishëm në përkrahjen profesionale kishin institutet profesionale që i trashëguem – Instituti i shkollimit në Republikën e Sllovenisë, i cili edhe sot merret me zhvillim dhe këshillim në kopshte femiore si dhe në arsimimin fillorë dhe atë të mesëm. Në vitet nëntëdhjetta iu vunë bazat edhe disa të rinjë. Tek në fillim të 1991 u formue Qendra andragogjike Sllovene, në vitin 1993 fituem RIC in, Qendra shtetërore e provimeve (parapërgatitjet në maturë, si dhe dhënja e provimeve të jashtme), me 1995 Qendra për edukim profesional (së bashku me Ministrinë e Punës dhe Dhomës ekonomike) Shkolla për drejtorë (drejtorët janë të obliguar të japin provimin që përgatiten në këtë shkollë, gjë që njëkohësisht punon në çështjet eksperte të menaxhimit shkollorë, kualitetit etj.) si dhe Qendra për aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore (rrjeti i konvikteve në lokacionet e ish karaulave (shkolla në natyrë, sport, shoqërimi i të rinjëve).

Të gjitha këto institucione u paraqiten pak a shumë si kundërpërgjegjëje në rregullimin e problemeve momentale por në zhvillimin e tyre të mëvonëshëm pranuen detyra speciale në lëmit e posaçme strategjike të sistemit edukativ. Në zgjedhjen e problemeve të grumbulluara u formuen instrumentet dhe dija për rekonstruktimin e tërsishëm të sistemit.

Studimi i zhvillimit të shkollimit në kontekstin ndërkombëtar

Siç theksuem reforma e shkollimit ishte ngushtë e lidhur me bashkpunimin ndërkombëtarë. Bashkpunimi bilateral se bashku me shtetet e Unionit europjan e posaçërisht me ato “pakica” në shumicën e rasteve u shfrytëzua për ndërrim të eksperteve dhe studim të praktikës së huaj. Në fillim me koshjencë u dha ndihëm eksperteve të rinjë në mënyrë që të u mundësohet qasja me çështje speciale në shtetet e ndryshme të Evropës (si psh. U formue kolektivi i shkollës për drejtpër). Vizitat institucioneve të aytre shteteve na mundësoi qasjen e eksperiencave që janë të rëndësishëm për krijimin e atrategjisë së ndryshimeve të sistemit vendorë të edukimit. Ajo gjë na mundësoi formimin e bazës së të dhënave dhe literaturës akceptimin e metodologjisë , përcjelljen e sistemeve edukative kurse në një nivel gjysëmformal (por shumë ndikues) kontaktet personale me ekspertet e jashtëm të mëdhenjë.

Shumë e rëndësishme ishte kyçja e programeve multilaterale. Sllovenisë, që në fillim, për fat të mirë i i shte hapur rruga në disa programe të komisionit europjan. Në fillim të viteve të

nëntëdhjetta vëmëndje të madhe për publikun e gjërë ishte programi TEMPUS. Aty behet fjalë për shkollim të lartë por përkrye Fakultetit pedagogjik të Univerzitetit në Lublanë dhe disa institucioneve tjera akademike u zhvilluen projektet e rëndësishë së veçant për edukimin e mësuesve dhe përparimit të shkollimit (shkencat natyore, gjuhët e huaja, mësimi klasorë etj.) Në suaza të programit PHARE (sot për nga fiklozofia është i ngjajshëm programi CARDS) kemi arrijt të zhvillojmë një seri projektesh për përparimin e edukimit profesional si në arsim të mesëm e poashtu dhe në atë të lartë. Përpos atyre projekteve komisioni europjan i cili ishte fakt moral dhe ndihmës material , duhet të rikujtojmë bashkpunimin e frytshëm me organizata ndërkombëtare siç është Këshillii i europës dhe UNESCO , kurse ne pjesen e dytë të viteve nëntëdhjetta edhe OECD. Me ndermjetsimin e atyre organizatave mundëm të shfrytëzojmë eksperetiza nderkombetare dhe të na vizitojnë ekspertet ndërkombëtarë. At ovizita dhe ndihmesa e eksperteve janë posaçërisht të rëndësishme në zhvillimin e projekteve siç ishte futja e maturës gjegjësisht provimeve të jashtme në reformat e shkollimit të lartë. Në aë kontekst duhet të cekim kyçjen e hulumtimeve ndërkombëtare të dijes (psh. TIMS) gjë që kërkojnë investime të dukshme të mjeteve vendore, por me shikim detal të funksionimit të edukimit, arritja e rezultateve dhe komparimi në nivelin ndërkombëtarë (poashtu dhe edukimi i analisteve vendorë) është i pagueshëm.Sa kam dijeni , Kroacia ka mundësi të kyçjes në projekte të ngjajshme të quajtur PISA (OECD).

Në pjesën e dytë të viteve nëntëdhjetta në ato baza dhe në lëmi të edukimit filloi e ashq. “ kyçja në Europë”. Bisedimet në mes qeverive dhe shteteve kandidate të komisionit europjan bëhen në mi tridhjetë lëmi. Bisedimet në lëmin e edukimit ishin në rënd dite në fillim të vitit (1997) dhe të mbyllura shumë shpejt me sukses. Në atë bazë na është hapur hyrja në programet e edukimit dhe ekspertimit të programeve të unionit europjan në maj të vitit 1998 : Socrates, Leonardo da Vinci dhe të rinjët për Europë. Shkollat tona dhe fakultetet, mësuesit dhe studentet e përjetojnë këtë hyrje së pari si stimulim për kualitet të arrijtjeve të veta.

4. Aplikimi i maturës së jashtme (1993-1995.)

Një nga projektet më të rëndësishëm në dhjtëvjjetshin e fundit është aplikimi i maturës. Vëndimii për maturë është marrë në vitin 1989, si një nga shumë ide në baticën e inovimeve shkolllore. Rrjedhat e bujshme ne dy vitet e ardhëshme ngadalësuen këtë projekt por, veçanarisht pas 1992 u qas në mënyrë energjike në parapoërgatitje konkrete. Me ndihmën e disa eksperteve ndërkombëtarë siç cekem filluen me punë komisione të shumfishta të lëndëve, u përgatitën testet, e parapërgatitëm vlerësuesit e jashtëm, u bë simulimi i notimit dhe e krejtë logjistika. Sistemi i notimit të jashtëm ishte i ndërlikuar. Gabimet që janë gjithëherë të mundëshme në atë sistem është vështirë të mshehen, dhe mundë të jenë të kobshme tek notimi tradicional. Gjithësesi për atë gjë kishte frigë tek nxënsit (dhe prindërit) e poashtu dhe te profesorët. Këtu është fjala për risin që e kemi vërejt vetëm në literaturë që eksplikoj eksperiencën e disa shteteve të Europës Përendimore, dhe nuk është e çuditshme që ato friksime i kapluan dhe ekspertet.

Faji ma i madh vinte nga qarqet laike si paralajmërim mbi “stërngarkim” të nxënësve. Në fakt nuk ishte fjala për ndonjë kritik sistematike por si përciellje e vlersimit që është ii njohur në të gjitha kulturat bashkëkohore në atë risi (të pa zbuluar ende). Faji filloi deri diku të shkrihet në procesin e dhënjës së katalogjeve maturale të cilët disa i quajtën si “marrëveshje” në mes shkollës dhe nxënsit. Ato katalogje janë përpjekje sistemore të futjes së standardeve (minimale) e që shkolla është e obliguar tu ofrojë nxënësve, e ai duhet ti zotëroj ato. Kultura e provimeve maturale u promovua si transparencë e detyrave dhe përgatitje e planifikuar për provim në kundërshtimnga ajo tradicionale, shpesh herë me eksaminim te kultures represive si

iniciim mistik. Debatet e gjata mbi procedurat dhe shkrimin e rregullave shumë të gjëra matura ndihmuen ne tejkalim të një çështje mjaft të rëndësishme, çështja e ndershmërisë (fairness) dhe objektivitetit të vlersimit të dijes dhe demokratizimit të metodave që përdoren. Objektiviteti i rezultateve të matures se jashtme ishte argumenti që ishte gjuhëz në peshore që bindi profesorët në gjimnaze dhe në fakultete (me atë perndryshe zvoglohet tensioni joformal, por ekzistues, psh. I prinderve e në veçanti i atyreve me status «profesorë»). Futja e matures se jashtme , fakultetet dhe universitetet çuen dorë nga provimet pranuese, kurse praktika e viteve të fundit tregon arësyeshmërin e këtij vendimi. Në komisionet matura të Indve qendrojnë se bashku profesorët e shkollave të mesme dhe ata universitarë, që i zbutë dyshimet e ndryshme dhe çka është më sësrëndësishmi , bënë lidhëshmërin konstruktive dy polet e hierarkisë vertikale.

Pas përgatitjeve intenzive dy vjetore si komisioni i vlersuesve të dijes në punën logjistike në nivel nacional poashtu dhe profesorët e nxënësit në shkollat në vitin 1994 u bë matura provuese në 10% të shkollave. Provimi kaloi pa probleme kështu që në vitin e ardhshëm (1995) matura u bë në të gjitha shkollat e mesme në vend. Përsos gjimnazeve në atë periudhë për maturë mundën të paraqiteshin të gjithë nxënësit e shkollave teknike profesionale (me program katër vitesh) kurse të tjerët edhe një kohë kishin alternativë për maturë dhe mundësi të aplikimit të provimit të mbrendshëm përfundimtarë. Futja e matures fuqishem e preki përgatitjen e nderrimeve konceptuale në shkollë të mesme.

5. koncepti i ri i edukimit dhe arësimit dhe legjislatura e re (1993-1996)

Me zgjedhjen e problemeve kyçe në edukim qëllimisht kemi provua të zgjedhim punën në disa projekte zhvillimore siç janë projekti i matures se jashtme (munde të cekim psh. Qasjet e reja në foshnjore, notën përshkruese apo mesimi gjuhëve të huaja në moshë të herëshme, sistemi dual në shkollat profesionale, shkollat e larta profesionale në edukim terciar etj.), eksperiencia e parë pozitive na bindi se erdhi koha për koncepte të tërsishme të edukimit dhe arësimit. Në atë drejtim u animue hapësirë e gjërë për ekspert të mësuesisë dhe filloi puna në sintetizimin e rezultateve të hulumtimit teorik i eksperiencës reale. Qëllimi i fundit ishte i dyfishtë: pranimi i dokumentit strategjik kombëtarë dhe në atë bazë pranimi i legjislaturës së re.

Pjesa e parë e qëllimit u realizue në “Librin e bardhë mbi edukimin dhe arësimin në Republikën e Sllovenisë” (nga mueji shkurt i 1995.; përkthimi anglez 1996.; përkthimi serb 2001.), që se pari e studjon filozofinë konceptet dhe qëndrimet teorike e pastaj elaboron të gjitha elementet e rëndësishme të vertikales edukuese sipas pjeseve të posaçme: nga foshnjoret publike, shkollës nëndëvjeçare, gjimnazit (të përgjithëshme gjegjesisht profesionalë) shkollave profesionale në mesimin e mesëm (me programe dyvjeçarë, tre dhe katërvjeçarë) të lartë (dy vjeçarë) dhe atij në fakultet (sipas programit tre dhe katërvjeçarë të studimit universitarë), dhe në fundë të edukimit tërëjetësorë, apo të edukimit të të rriturve. Edukimi i mësuesve parashef studim universitarë. Dokumentin e plotësoi analiza konceptuale e shkollave publike dhe private. Shkollat publike janë të bazuara në neutralitet juridik dhe në sistem të vlerave të përbashkët siç është demokracia, solidariteti, toleranca, aty është e lejuar aktiviteti fetarë, partijak apo aktivitete të ngajshme, kurse shkollat private mundësojnë doktrina të posaçme pedagogjike ose konfesionale, e njëkohësisht janë të financuara nga buxheti shtetrorë në përqindje të madhe 85%.

Krahas shkrimit të “librit të bardhë” vijoj shkrimi i legjislaturës së re, gati në “paket “. Në vitin 1993 në Parlament u pranua “Ligji mbi shkollimin e lartë” i cili në mes tjerash futi

maturen e jashtme si kusht për rregjistrim ne studimet universitare (për rregjistrim ne studimet e larta profesionale mundeshin te kandidojnë edhe me provim përfundimtarë) dhe ne këtë mënyrë u hoqen provimet pranuese. Tok me daljen e “Librit të bardhë” ministria e kreu punen dy vjeçare në përgatitjen e propozimeve ligjore ne te cilat punuen shume ekspert dhe jurist. Ne pranveren e 1995 ky paket i propozimeve Qeveria e dërgoi në Parlament. Procedura e tre leximeve parlamentare zgjati një vit. Ne pranverë te 1996 u pranuen ligjet siç “ Ligji mbi organizimin dhe financimin e edukimit dhe arësimit”, si ligj kulmorë si dhe ligjet regionale siç “ Ligji mbi foshnjore”, “Ligji mbi shkolla fillore”, “Ligji mbi arësimimin profesional”, “Ligji mbi Gjimnaze”, “ligji mbi edukimin e të rriturve”. Pas disa muejsh u pranua “ligji mbi inspektionin shkollorë” i cili ishte diametral me koceptin klasik të inspekcioneve shkollore duke futur forma moderne, kurse e përcollën masat e futjes së proceseve të (vetë) kontrollës dhe sigurimit të kualitetit në shkolla.

Pas «paketit» të gjashtë ligjeve pasuen edhe disa. Ashtu, ne vitin e kaluar (2000.) u pranuen «Ligji mbi drejtimin e femijve me kërkesa të veçanta», «Ligji mbi edukatën muzikore» dhe «Ligji mbi kualifikimet nacionale profesionale». U pranuen (dhe përgatiten) shtesat ligjore te aprovuara ne vitin 1996 . Ne vitet e kaluara u përgatit mbi 300 rregullore nenligjore. Natyrisht, fjala është për sistemi juridik i cili duhet të mundësoj ndryshime reale ne punë të foshnjoreve dhe shkollave.

6. Futja e ligjeve të reja në praksen arësimore (1996-2000)

Përgatitja e legjislatures se re , ndryshimi i sitemit shkollorë, u bë normë të cilën duhet realizuar. Periudha nga 1996 deri 1998 karakterizohet me ndryshime përmbajtësore për të cilat u kujdes trupi ekspert i posaçëm të cilin e emëroi Qeveria e Republikës Sllovene/ Këshilli kombëtarë kurikulues. Ai këshill ishte i ngarkuar me përgatitjen e kurikulimit të ri në krejtë vertikale, kurse në atë punë ndihmuen komisionet regjionale kurikulare (shkolla fillore, gjimnazi të rriturit etj.) komisionet e lendëve kurikulare dhe puna e mësuesisë në aktive. Me atë në proces të vertetsimit dhe përgatitjes se propozimeve të kurikulumeve të rinjë u fut numër i ri i ekspertevedhe mësuesve. Debatet dyvjeçare ishin të zjarra dhe të hapura, e kryesisht prunë vendime konsensuale.

Kurikulumi i këshillit nacional kishte detyrë të japin propozime të kurikulimit të ri të këshillave kompetente eksperte (shif më lartë pika 2.) dhe ata ne vitin shkollor 1998./99, e fituen shumicën.

6.1. Edukimi i herëshem dhe arësimi

Qellimi themelorë i ndërrimeve kurikulare në periudhën e herëshme ishte kyçja e numrit të madhë i femijve (tash jane te kyçur 60% të fëmijve) ne foshnjore me fleksibilitetin dhe rritjen e kualitetit të programit të foshnjoreve. Kurikulumi i ri për (foshnjore publike) ishte i pranuar ne vitin 1999. Parimet e tij dalin nga Konventa mbi të drejtat e fëmijve , kurse bëhet fjalë për kalimin konceptual nga tradicjonalja e paraqitjes së procesit të edukimit dhe arësimimit të herëshëm. Është i drejtuar në motivimin e fëmijve dhe rëndësi të veçant i kushton individualizimit. Ne lëmit e veprimtarisë në kurikulumin e ri njhsohen levizja, gjuha, arti, shoqëria, natyra dhe matematika, që janë në bashkrenditje dhe lidhshmëri te ndersjelltë. . Elemntet e kurikulimit te ri filozofik janë të dukshëm në respektimin e identitetit familjarë, kyçjes së prindërve në planifikimin e punës, të drejtës në adaptimin shkallzues të fëmijve në foshnjore etj. Kurikulumi i ri ofron fleksibilitet të madh, posaçërisht me ofertë të shkurt programit (gjysëmditorë). Futja në foshnjore eshte shkllzuese: rreth 25% foshnjore (vullnetarisht) filloi të fus kurikulum të ri në vitin shkollorë 1999/2000.

6.2. Shkolla fillore

Vendimi më i rëndësishëm ishte i pranuar në Parlament; vendimi mbi shkollën nëndëvjeçare si shkollë fillore. Shkolla filloi në moshën 6 vjeçare të fëmijës, me fillim të butë në të cilin parashifet ndërrimi i plotë i filozofisë së fillimit të shkollimit: në atë proces edukatorja dhe mësuesja punojnë së bashku në grupe. Shkolla fillore është e ndarë në tri “triada” e në fundë të trijadës parashikohet kontrolli nacional i dijës së përfituar (përgatitja e atij nënsistemi është në rrjedhë e sipër). Kontrollimi në fundë të trijadës së parë dhe të tretë parashikohet si monitoring, kurse kontrollimi i jashtëm në fundë të shkollës fillore në një numër të bodave (pjesa e dytë është nota e arësimitarit) ndikon në notën përfundimtare të nxënësit. Shkolla nëndëvjeçare është e përciellur me shumë ndërrime të përmbajtjeve didaktike, psh. nota përshkruese kurse në trijaden e fundit futet diferencimi (fleksibil) dhe lëndet zgjedhëse. Çdo nxënës duhet të zgjedhi tri lëndë zgjedhëse mes shkencave natyrore/teknike dhe humanistike/shoqerore. Deri sot është zhvilluar katërdhjet programe të ndryshme zgjedhëse (shkolla duhet të ofrojë më së paku gjashtë lëndë kurse në zgjedhje duhet respektuar traditën e shkollës, karakteristikat lokale, interes specifike të fëmijëve gjegjësisht të rrethit, mundësit e shkollës dhe kolektivit të arësimitarëve etj.). Këshilli profesional para disa kohe ka pranua programin e lëndëve zgjedhëse të gjuhës kroate, i cili do të jetë i posaçëm dhe interesant për regjionin buzëkuftarë.

Futja graduale e kurikulimit nëndëvjeçar si shkollë fillore. 10% të shkollave (ne bazë të konkursit të hapur) filluan në vitin shkollor 1999/2000., rreth 25% të shkollave do të angazhohen në vitin 2000/2001, rreth 40% të shkollave në vitin shkollorë 2001/2002, kurse të gjitha shkollat fillojnë me vitin shkollorë 2003/2004. Futja e shkollës nëndëvjeçare është e përcjellur me përgatitjen sistemore të mësuesve (edukimi obligues i shtuar). Në periudhën e tashme të futjes graduale të nëndëvjeçares kujdes i veçant i kushtohet programit tetëvjeçar gjegjësisht përndryshueshmërisë apo modernizimit. Një nga problemet themelore në lëmin e shkollës fillore është zvoglimi i popullatës dhe me të rrjetit shkollorë. Shtimi i shkollës në nëndëvjeçare dhe përmirsimi i standardit (psh. grupet e vogla) në ato rrethana mundë të zbuten tensionet që në të kundërtën do shpërthejnë (psh. shtesë e mësuesve).

6.3. Edukimi profesional

Në vet filozofinë të edukimit profesional parimi më i rëndësishëm i partneritetit shkollorë dhe ekonomisë. Ky parim reflektohet në Këshillin për edukimin profesional të Republikës së Sllovenisë, që ka strukturë trepartite (pedagogët, punëdhënësit, sindikati). Kërkesat e reja të tregut të punës janë piknisje e kreimit të kurikulimit të ri. Këtu bëhet fjalë për programin fleksibil të edukimit profesional. Këtu janë programe të shkurtëra deri në dy vite, janë të dedikuara popullatës rizike, e të përgatitur për metoda alternative, përsëmbull shkolla produktive (margjinalizimi i të rinjëve për hyrje të serishme në sistemin e rregullt të shkollimit). Në sistem janë të ruajtur “shkollat profesionale” trevjeçare që ofrojnë sistemin “dual” shkollorë. Sistemi dual mbetet përafërsisht 5% të tersisë së popullatës shkollorë, kurse nuk ishte i paraparë si “magjistrale” e madhe edukative: mvaret nga interesi i të rinjëve dhe oferta e ndermarrjeve. Shkollat katërvjeçare profesionale (shkollat teknike) u bënë forma më dominante por duhej që nën ndërrimet e edukimit të tërsishëm të gjejë vendin e vetë parasegjithash në mvarshmeri ndaj gjimnazit teknik. Ata që kryejnë “shkollat profesionale” u ofrohet sistemi “3+2”. Dy vite shtesë të arritjes së kualifikimit të teknikëve.

Këto forma janë vazhdimësi e programit që e kishim edhe me parë, e si risi tjera janë fut kurset e mjeshtrave dhe shkollat profesionale (dyvjeçare). Kursi i mjeshtrave mundëson

titullin mjeshtër kurse kurse kurse profesional është i dedikuar gjimnazisteve që nuk mendojnë të studiojnë por dëshirojnë të përfitojnë kualifikime të punës. Shkollat e larta profesionale janë pjesë e edukimit terciar por të ndarë nga shkollimi i lartë. Qëllimi i tyre është profesionalizmi cilësorë kurse shkollat e larta profesionale duhet të marrin një nga qendrat zhvillimore regjionale në Slloveni. Momentalisht janë afro 20 shkolla të tilla me afro 5000 student. Ato shkolla kryejn rrol pozitiv posaçërisht në edukimin e të rriturve (në bashkpunim me ndermarrje të mëdha regjionale).

Arësimimin profesional e përciellin përmbajtje të shumta didaktike në nivelin sistemorë është kalim i rëndësishëm në provim përfundimtarë. (i futur me 1990/1991) në “maturen profesionale” (e cila hini në shkolla me 2001/2002.) Ndërrimin e ligjeve mbi shkollimin e lartë (1999) nën kushte të caktuara.

6.4. Gjimnazi

Gjimnazi tradicional i cili në vendin tonë u anashkalua në vitet tetëdhjetta me rastin e futjes së arësimimit të orjentuar, u rikëthye në vitet e fundit të tetëdhjetave. Këthimi i saj e shpejtësuen programet bashkëkohore dhe risit tjera prej të cilave më e rëndësishmja ishte hyrja e matures së jashtme 1995. Për këtë gjë ndërrimet kurikulare nga pjesa e dyte e viteve nëntëdhjetta për gjimnaz nuk ishin aq të mëdha si psh. për shkollën fillore. Gjimnazi mbetet konceptualisht përgatitore për arësimimin e lartë, e interes i madhë për shkollim ka ofertë programore fleksibile ndaj diferencimit të gjimnazit të përgjithëshëm dhe atij profesional. Te dy shkollat janë përgjithsisht edukativepor shkollat profesionale janë “të ngjyrosura” kështu që një pjesë e programit (psh. teknika dhe ekonomija) fitojnë peshë të madhe, kurse zvoglohet vëllimi i lëndëve tjera. Poashtu gjimnazin e përciellin ndërrime përmbajtësore didaktike, dhe ndoshta është më së rëndësishmi se në të zhvillohen lëndë zgjedhëse. Si “kurset profesionale” mundësojnë kalueshmërinë në sistem për ata gjimnazist të cilët nuk kanë ndërmendë të studiojnë në shkollën e lartë, kështu futja e “kursit maturar” njëvjeçar u mundësoi nxënësve të përgatiten për maturë të jashtme dhe vazhdojnë edukimin e shkollimit të lartë.

6.5 Shkollimi i mësuesve

Paralelisht me krejt ndërrimet u ndërrua sistemi i shkollimit të mësuesve. Në fakt në mesin e viteve të tetëdhjetta u prur vendimi mbi transformimin e Akademisë pedagogjike së atëherëshme në Fakultet pedagogjik në suaza të Universitetit të Lubjanës dhe Mariborit. Nuk bëhet fjalë vetëm për ndërrim emrash por, për koncepte të ndryshme që kujdeset për gradualitetin e ndryshimeve në sistemin edukativ si tërësi. Koncepti i edukimit universitar të mësuesisë me koshjencë përmbledhin komponentën hulumtuëse karakteristike për studimin universitarë në përgjithësi. Nga ana tjetër futja e studimit deridiplomik të studimit universitarë ishte e drejtuar në formimin e kushteve për fillimin e studimit pasdiplomik (specializim, magjistraturë, doktorat) . Këtë shkallë e arrijtëm në mes të viteve nëntëdhjetta.

Përpos studimit deridiplomik (“pre-service”) shkollimi i mësuesve shumë më shumë kujdes i kushtohet në perfeksionizmin profesional (“in-service”) Ajo u realizua në disa trajta. Perfeksionizmi profesionist është më masivi. Ato janë module në të cilat kyçen shumica e mësuesve. Këto module të zgjidhjeve të këshillit profesional në bazë të konkursit të hapur, edhe këta në atë mënyrë që të fromohet ofertë e madhe fleksibile e që shkollat dhe mësuesit i përzgjedhin sipas hamndjes së tyre. Ministria nuk ndikon në vendimet profesionale por me financim e stimulon (pjesërisht apo në tërësi) aplikimin e programeve që janë më rëndësi të

posaçme për zhvillimin e edukimit. Programet aplikohen në institucione të ndryshme nga Institutet për shkollim deri në fakultete, nga instituti deri te shoqatat profesionale.

Forma e dyte e profesionalizimit janë të ashq. Programet studimore për perfeksionizem. I mbajnë në përgjithësi fakultetet (programet që në praks zgjasin dy muej deri ne një vit), kurse kandidatit i bjen licencë për studimin e risive kurikulare. Kështu për shembull , fakultetet ne vitet e kaluara për mësues të ciklit të ulte dhe atij të lartë i mbajne ligjeratat sipas programit studimorë në trijadën e parë të shkollës nëntëvjeçare, për mësimin e herëshem të gjuhëve të hueja për studimin e Natyrës (në triaden e tretë) programi Religjioni dhe etika (per disa lëndë tjera zgjedhëse nga trijada e tretë). Për punë në Gjimnaze mbahen programet për specializimin e mësuesve dy lëndësorë për intenzimin dhe studimin e një lënde. Në atë kontekst zhvillohet i ashq. Specializimi andragogjiko/pedagogjik që i jep liçencë diplomanteve të lëndev jopedagogjike (psh.inzhinjeri për për shkolla profesionale).

Duhet cekur dhe nje forme te re të specializimit: pra, studimi mbas kryerjes dhe fitimit të diplomës (te dikurshme) shkolles se naltë (qe ka zgjatur 2 vite) . Ky lloj studimi për mësues të punësuar në mnyrë financiare u ndihmon kurse rezultatet jane te dukshme ne avancimin e dijes se tyre, si dhe promovimi i tyre individual.

Literatura

- Bela knjiga o vzgoji in izobraževanju v Republiki Sloveniji* (1995), ur. J. Krek. Ljubljana: Ministrstvo za šolstvo in šport.
- Bahovec, E. D., Kodelja, Z. (1996), *Vrtci za današnji čas*. Ljubljana: Center za kulturološke raziskave pri Pedagoškem inštitutu in Društvo za kulturološke raziskave.
- Evalvacija* (2000.), ur. Darko Štrajn. Ljubljana: Pedagoški inštitut.
- Gaber, S. (2000), *The Decade of Change*. Ljubljana: CEPS <http://pef.pef.uni-lj.si/ceps/>
- Gabršček, S., Bethell, G. (1996), *Matura Examinations in Slovenia. Case Study of the Introduction of an External Examinations System for Schools*. Ljubljana: National Examination Centre.
- Izhodišča za evalvacijo kurikularne prenove vzgoje in izobraževanja v Republiki Sloveniji*. (1999) Nacionalna komisija za uvajanje in spremljanje novosti in programov v vzgoji in izobraževanju. Ljubljana: Ministrstvo za šolstvo in šport.
- Kakovost v vzgoji in izobraževanju*. Sodobna pedagogika. Vol. 51 (117). No. 4. Ljubljana, junij 2000.
- Kodelja, Z. (1995), *Laična šola. Pro et contra*. Ljubljana: Mladinska knjiga.
- Kongres pedagoških delavcev Slovenije. Programska prenova naše osnovne in srednje šole. Zbornik prispevkov*. Portorož, 13. do 15. marca 1997.
- Kosovel, I. (1990), *Vzgoja proti izobraževanju. Razprave in eseji*. Ljubljana: Slovensko društvo raziskovalcev šolskega polja.
- Kramar, J., Zgaga, P. (ur.) (1997), *Strokovna izhodišča za nacionalni program visokega šolstva v Republiki Sloveniji*. Ljubljana: Ministrstvo za šolstvo in šport, julij 1997.
- Medveš, Z., Muršak, J. (1993), *Poklicno izobraževanje — problemi in perspektive*. Ljubljana: Slovensko društvo pedagogov.
- Milharčič-Hladnik, M. in Šušteršič, J. (1986), *Šolska reforma je papirnati tiger*. Ljubljana: KRT.
- Pediček, F. (et al.) (1990), *Šola v političnem pluralizmu*. Zbornik razprav. Ljubljana: Marksistični center CK ZKS.
- Razvoj visokega strokovnega šolstva v Republiki Sloveniji. Referati in poročila s tematske konference v Portorožu, 21.—23. april 1994*. Ur. P. Zgaga. Ljubljana: Ministrstvo za šolstvo in šport, 1994.
- Reviews of National Policies for Education. Slovenia*. Organisation for Economic Co-operation and Development, Centre for Co-operation with Non-members. OECD. Paris, 1999.

- Slanc, A. (ur.) (1996), *Srednješolsko izobraževanje v Republiki Sloveniji 1990.—1996*. Ljubljana: Ministrstvo za šolstvo in šport.
- Šolska zakonodaja I*. Ministrstvo za šolstvo in šport. Ljubljana, april 1996.
- The Education System in Slovenia 1997.—1998*. Ministry of Education and Sport. Ljubljana, June 1998. (National Eurydice Office).
- The Education System in Slovenia 1999*. Ministry of Education and Sport. Ljubljana, December 1999. (National Eurydice Office).
- The Education System in Slovenia 2000*. Ministry of Education and Sport. Ljubljana, December 2000. (National Eurydice Office).
- Ugotavljanje in zagotavljanje kakovosti v vzgoji in izobraževanju*. Zavod za šolstvo RS, Šola za ravnatelje, Center RS za poklicno izobraževanje, Ministrstvo za šolstvo in šport. Portorož, november 1999. (Nelektorirano delovno gradivo.)
- Vzgoja v javni šoli. Zbornik tekstov*. Ur. Zdenko Medveš (et al.). Ljubljana: Znanstveno in publicistično središče v sodelovanju s Slovenskim društvom pedagogov, 1991.
- Vzgoja v javni šoli*. Sodobna pedagogika. Vol. 51 (117). No. 1. Ljubljana, januar 2000.
- Zaposlovanje: približevanje Evropi*. Ur. Sonja Pirher in Ivan Svetlik. Ljubljana: Fakulteta za družbene vede, 1994.
- Zasebno šolstvo. Struktura, primerjava različnih šolskih sistemov in zakonodajne rešitve v Republiki Sloveniji*. Ljubljana: Ministrstvo za šolstvo in šport, julij 1996.
- Zbornik Evropski trendi v izobraževanju učiteljev*. Ur. M. Peček-Čuk. Ljubljana: Pedagoška fakulteta Univerze v Ljubljani, 1998.
- Zbornik Izobraževanje učiteljev ob vstopu v tretje tisočletje. Stanje — potrebe — rešitve*. Ljubljana: Pedagoška fakulteta Univerze v Ljubljani, 1997.
- Zbornik Izobraževanju učiteljev za prenovljeno šolo*. Ur. J. Hytönen, C. Razdevšek Pučko, G. Smyth. Ljubljana: Pedagoška fakulteta Univerze v Ljubljani, 1999.
- Zbornik Kurikularna prenova*. Nacionalni kurikularni svet. Ur. Andreja Barle Lakota, Katra Bergant. Ljubljana, marec 1997.
- Zbornik Prvi strokovni posvet o maturi*. Ljubljana: Republiški izpitni center, 1995.
- Zbornik Šola in učitelj na vajah države*. Ur. M. Milharčič Hladnik, M. Šebart. Ljubljana: Slovensko društvo pedagogov, 1991.
- Zbornik Teorija vzgoje: moderna ali postmoderna? Šolsko polje 3*. Ur. E. D. Bahovec, Z. Kodelja, P. Zgaga. Ljubljana: Studium generale Univerze v Ljubljani, 1990.
- Zbornik Verouk v šole?! Šolsko polje 4*. Ur. S. Gaber, Z. Kodelja. Ljubljana & Škofja Loka: Krt & Zamorc, december 1990.
- Zgaga, P., *Educational Policy and Quality in Education*. In: Ways towards Quality in Education. Ed. by I. Stronach, N. Trunk-Širca, N. Dimc. Open Society Institute Slovenia: Ljubljana 2000., pp. 39—50.

Verejtje: shumicën e veprave të cekura si dhe vepra të tjera mundë ti gjeni në adresen elektronike <http://www.see-educoop.net>

Perkthyer nga: Martin Berishaj
Perkthimi u mundësua nga SEE ECN.